

HIGJIENA SH.A.

02/FINANCAJ 965
09 20 08/2024
DEÇAN DEÇAN



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "HIGJIENA" SH.A - DEÇAN

Raporti financiar

Janar – Qershor

2024

Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Klientët.....	5
Faturimi /Planifikimi.....	6
Inkasimi / Planifikimi	7
Shpenizmet	8
Problemet dhe sfidat	9

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për periudhën kohore Janar – Qershor të vitit 2024 paraqet një përmbledhje të gjitha aktiviteteve financiare të zhvilluara gjatë këtij gjashtë-mujori .

Në raportin e punës për periudhën gjashtëmujore të vitit 2024 do të prezantohen në mënyrë të detajuar numri i klientëve të shërbyer, me të dhënat financiare që lidhen me afarizmin e kompanisë gjatë kësaj periudhe duke përfshirë edhe të hyrat e tërësishme, shpenzimet e krijuara, dhe të gjitha të dhënat e tjera të cilat lidhen me periudhën raportuese.

HYRJE

Bazuar në Ligjin për Mbeturina, Ligjin për Ndërmarrje Publike, Statutin e NPL “Higjiena” Sh.A. si dhe Rregullorën e Punës së kompanisë lidhur me hartimin e raporteve të punës dhe rezultatet e arritura gjatë periudhave të caktuara kohore, në vazhdim po e paraqesim raportin e punës për periudhën kohore Janar – Qershor 2024.

Në vazhdim të raportit do të prezantohen në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat relevante të cilat janë të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të qartë për afarizmin e NPL “Higjiena” Sh.A. Deçan gjatë kësaj periudhe.

KLIENTËT DHE KATEGORITË E TYRE

Në bazë të të dhënave të NPL “Higjiena” Sh.A. për periudhën raportuese numri i klientëve që është faturuar është 8394 klientë.

Nëse do të krahasonim të dhënat për të njëjtën periudhë e njëjtë të vitit 2023 ishin 8252 klientë shohim se në vitin të 2024 kemi një rritje për 142 klientë

Analizuar sipas kategorive të klientëve të shërbyer në këtë vit ashtu si edhe në vitet paraprake në amvisëri kemi rritje prej 136 klientë, biznese 3 klientë dhe institucione 3 klientë.

Në mënyra tabelare është paraqitur më poshtë.

NPL “Higjiena” Sh.A Deçan

Kategoria e shërbimit	TM2 2024	TM2 2023	Diferenca
Amvisëri	7777	7641	136
Biznese	593	590	3
Institucione	24	21	3
Totali	8394	8252	142

Tab.1 Kategoritë e klientëve të NPL Higjiena Sh.A – TM2 2024/TM2 2023

Të hyrat

Në 6 muajt e parë 2024 kompania ka arritur që kërkesat tona ndaj klientëve të arrinin vlerën e faturimit prej 437,240.68 €, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë 2023, 356,015.98 € kemi një rritje të konsiderueshme me diferencë prej 81,224.70 €, apo shprehur në përqindje 18.57 %

Paraqitja tabelare

Faturimi 2024	Faturimi 2023	Diferenca në Euro	Diferenca në %
437,240.68 €	356,015.98 €	81,224.70 €	18.57 %

Tab.2

Planifikimi i faturimit dhe realizimi në periudhën Janar -Qershor 2024

Realizimi i faturimit për gjashtë-mujorin e vitit 2024 kundrejt planifikimit paraparak për këtë periudhë është realizuar në 88% apo në vlerë prej 478,219.93 € kundrejt planifikimit prej 541,104.00 € në vitin 2024.

Planifikimi i faturimit 2024	Faturimi 2024	Realizimi në %
541,104.00 €	478,219.93 €	88 %

Tab.3

Raporti financiar për Janar – Qershor 2024

INKASIMI

Në këtë periudhë raportuese të vitit 2024 kompania ka arritur që inkasimin e mjeteve nga klientët të arrinin vlerën prej 430,397.93 €, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë 2023 352,347.53 € kemi një rritje të prej 78,050.00 €, apo shprehur në përqindje 22.15 %.

Inkasimi 2024	Inkasimi 2023	Diferenca në shifra	Diferenca në %
430,397.93 €	352,347.53 €	78,050.00 €	22.15 %

Tab.4

Planifikimi i inkasimit dhe realizimi në periudhën Janar -Qershor 2024

Realizimi i faturimit për gjashtë-mujorin e vitit 2024 kundrejt planifikimit paraprak për këtë periudhë është realizuar në 88 % apo në vlerë prej 430,397.93 € kundrejt planifikimit prej 486,993.60 €.

Planifikimi i inkasimit 2024	Inkasimi 2024	Realizimi në %
486,993.60 €	430,397.93 €	88 %

Tab.5

SHPENZIMET E VITIT 2024 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2023 (gjashtë-mujori)

NPL „Higjiena“ Sh.A Deçan

Shpenzimet e ndodhura në gjashtë mujorin e viti 2024 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë 2023.

Nr.	Emërtimi	Shpenzimet 2024	Shpenzimet 2023	Diferenca 2023	Diferenca në %
1	Paga Bruto	248,129.69 €	161,280.81 €	86,848.85 €	35.00 %
2	Shpenzimet e derivateve	50,380.97 €	49,150.64 €	1,230.33 €	2.44 %
3	Shpenzimet e mirembajtjes	12,179.86 €	14,824.41 €	-2,644.55 €	-21.71 %
4	Shpenzime për mallra dhe shërbime	18,241.68 €	9,890.99 €	8,350.69 €	45.78 %
5	Shpenzimet e rrymes dhe ujit	2,505.24 €	2,856.58 €	-351.34 €	-14.02 %
6	Shpenzimet e regj. të automjeteve	1,977.69 €	2,522.42 €	-544.73 €	-27.54 %
7	Shpenzime tjera (deponia)	32,973.79 €	27,161.30 €	5,812.49 €	17.63 %
	Totali	366,388.92 €	267,687.15 €	98,701.77 €	26.94 %

Tab.6

Nga tab.6 shohim që në krahasuar me vitin 2024 kemi rritje të shpenzimeve për total 98,701.77 €, apo 26.94 %.

Arsyeja e kësaj rritje janë rritja e shërbimit si në aktivitetin primar dhe sekondar, që rrjedhimisht sjellë deri të rritja edhe shpenzimeve.




Fig.1 Krahasoni i shpenzimeve të të njëjtës periudhë të vitit 2024 me atë të vitit 2023.

Problemet dhe sfidat gjatë kësaj periudhe

Viti 2024 dhe konkretisht periudha për cilën po raportohet është karakterizuar me një rritje të shpenzimeve sidomos në shpenzimet për paga dhe mallra dhe shërbime. Arsyeja e rritjes së këtyre shpenzimeve është se kompania NPL “Higjiena” Sh.A ka nënshkruar 3 kontrata me komunën e Deçanit, të cilat e kanë detyruar kompaninë që të rrisë numrin e punëtorëve specifikisht për këto kontrata, e që njëkohësisht është rritur shumë edhe shpenzimet e pagave siç shihet më lartë në raport, po ashtu shpenzimet për mallra dhe shërbime. Rritje ka pasur edhe shpenzimet për deponinë si shkak i rritjes së tarifës së deponisë nga operatori me të cilin bashkëpunojmë. Vlen të ceket se shpenzimet e derivateve janë thuajse të njëjta, ndërsa shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve janë ulur krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Përpilues:

Albanë Avdiu – Zyrtare Kryesore Financiare

Sali Kuçi – Shef i Kontabilitetit

Bleron Tolaj – Çertifikues i Pagesave

